



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8, 11.1 dhe 22 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot.01-413/01 -0071612/23, të datës 27.09.2023, Për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe Parashikimet Buxhetore 2025-2026, në implementimin e projektit "Përkrahja me Fidane të Mjadrës", në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0021330/24 të datës 03.04.2024, për shqyrtimin edhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve sipas Ftesës Publike nr.12-320/01-0017267/24, të datës 11.03.2024, Kryetari i Komunës, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

1. Lejohen mjete financiare për subvencionimin e katër (4) fermerëve përfitues të Komunës së Podujevës për kultivimin e mjadrës.

2. Mbështetja e fermerëve do të bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural në ftesën publike për aplikim në projektin "Përkrahje me Fidane të Mjadrave", në shumë të përgjithshme 4,400.00€ për katër (4) fermerët përfitues përkatësisht në vlerën prej 1,100.00 € si vlerë e mbështetjes për një (1) fermer/e.

#### Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

#### Neni 3

Lista e aplikuesve të përzgjedhur për implementimin e projektit: "Përkrahje me Fidane të Mjadrave", sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

#### Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtorisë së Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, i cili do të bëjë verifikimin, konstatimin dhe vlerësimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara sipas ftesës publike përkatëse.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot. 02-400/01-0036449/24  
Podujevë, datë 05.06.2024



Kryetari i Komunës  
Shërbëtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L - 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafët 1, 3.1, 3.2 dhe 3.6, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022 sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 02-400/04-0033793/24, të datës 24.05.2024, merr:

### V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

#### Neni 1

znj. [redacted] nga fshati Gllamnik, Komuna e Podujevës, për shkak të gjendjes së rënde shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor si dhe gjendjes së rënduar ekonomiko-sociale i jepet ndihmë financiare në shumë 500.00€.

#### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare të së përmendurës.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.

Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF.

QSHQ/Arkivit.

znj.Shukrije Mustafa (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.prot 02-400/04-0036451/24  
Podujevë, datë, 05.06.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNITA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNITA E KOSOVËS - REPUBLICA OF KOSOVO DIREKTORIA E KONTROLLIT DHE PRIPAVALITETIT DIREKTORAT E KONTROLI I DREKTORAT E KONTROLI I DREKTORAT E KONTROLI I		
Dokument nr. Dostavljeno 11.06.2024		
Nr. orig. Org. kod	Nr. Bil.	Shtypje - Printig
02-016/01-0037988/24		
PODUJEVË - PODUJEVO		



Komuna e Podujevës  
Opština Podujevo  
Municipality of Podujeva

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës  
Univerziteteska Bolnička i Klinička Služba Kosova  
Hospital and University Clinical Service of Kosovo

Në mbështetje të neneve 5 d), 14.1 dhe 58 a,d) të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe Ligjit nr. 06/l-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 3 paragrafi 1.4, 17.1 dhe 61 paragrafi 1.1 dhe 1.4 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18,

Nenit 62 të Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi dhe në pajtim me Statutin e SHSKUK-së,

Vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë nr.05-2084 datë 25.03.2024 për themelimin e Poliklinikës Specialistike në Komunën e Podujevës, Vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë nr.05-1806 datë 13.03.2024 për funksionalizmin e Poliklinikës Specialistike në Podujevë, si dhe në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0025470/24 datë 18.04.2024 për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë SHSKUK-së, lidhet;

### KONTRATË PËR DHËNIE NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

E lidhur në mes;

**Komunës së Podujevës**, në cilësinë e dhënësit në shfrytëzim të pronës komunale, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës Shpejtim Bulliqi, (në tekstin e mëtejme **Komuna**)

dhe

**Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës - SHSKUK**, në cilësinë e marrësit në shfrytëzim të pronës komunale, përfaqësuar nga Drejtori i SHSKUK-së Elvir Azizi, (në tekstin e mëtejme **SHSKUK**)



## **Neni 1**

### **Objekti i kësaj Kontrate**

Objekt i kësaj Kontrate është prona komunale e evidentuar në certifikatën pronësore nr.08-942/06-0023271/24 të datës 11.04.2024, njësia kadastrale parcelë: P-71712062-01012-10, në sipërfaqe 3035m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Podujevë, duke përfshirë edhe objektin ekzistues shëndetësor, e cila i jepet në shfrytëzim afatgjatë SHSKUK-së.

## **Neni 2**

### **Qëllimi**

Prona e paluajshme sipas nenit 1, jepet në shfrytëzim pa pagesë, me qëllim të funksionalizimit të Poliklinikës Specialistike në Komunën e Podujevës, e themeluar nga Ministria e Shëndetësisë me Vendimin nr.05-2084 të datës 25.03.2024, dhe Vendimin nr.05-1806 të datës 13.03.2024.

## **Neni 3**

### **Të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese**

#### **Komuna:**

1. I mundëson SHSKUK-së shfrytëzimin e pronës së paluajshme në mënyrë të papenguar, si dhe siguron dokumentacionin e nevojshëm në kuadër të autorizimeve ligjore në funksion të funksionalizimit dhe realizmit të projekteve në kuadër të Poliklinikës Specialistike në Komunën e Podujevës.
2. Mundëson dhe siguron qasje të papenguar në hapësirën përkatëse për qëllim të funksionalizimit të Poliklinikës Specialistike përfshirë edhe zbatimin e projekteve përkatëse të SHSKUK-së në atë hapësirë dhe objekt, si dhe zgjerimin dhe adaptimin e të njëjtit për nevoja të Poliklinikës Specialistike.
3. Komuna e Podujevës ka obligim të iniciojë procedurat për marrjen e pëlqimeve për kyçje në rrjetin elektro-energjetik dhe në shërbime tjera komunale duke përfshirë rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit, sanitari dhe të tjerat të nevojshme.

#### **SHSKUK:**

1. Ka të drejtën e shfrytëzimit të pronës së paluajshme, objekt i kësaj Kontrate.
2. Ndërmerr të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për funksionalizimin e Poliklinikës Specialistike në Komunën e Podujevës duke marrë për bazë Vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë për themelimin e Poliklinikës Specialistike në Komunën e Podujevës, dhe Vendimin për miratimin e Planit të Veprimit për funksionalizimin e Poliklinikës Specialistike në Podujevë, si dhe vendimet tjera pasuese që mund të rrjedhin në të ardhmen për avancimin e shërbimeve shëndetësore në kuadër të kësaj Poliklinike.
3. Me funksionalizimin e Poliklinikës Specialistike në Komunën e Podujevës, e njëjta organizohet, mirëmbahet, menaxhohet dhe administrohet nga SHSKUK, konform legjislacionit përkatës në fuqi.
4. SHSKUK, merr përsipër obligimet e shpenzimeve të komunalisë (energji elektrike, furnizim me ujë, mbeturinave dhe ndonjë obligim tjetër që mund të rrjedh në të ardhmen) sipas Statutit të SHSKUK-së, Ligjit për Shëndetësi dhe akteve tjera përkatëse në fuqi.
5. SHSKUK, merr përsipër rekrutimin e stafit shëndetësor dhe administrativ për nevojat e Poliklinikës Specialistike në Podujevë.



6. SHSKUK, merr përsipër kompensimin e stafit të rekrutuar përmes sistemit të pagave.
7. SHSKUK, pas funksionalizimit të Poliklinikës Specialistike në Podujevë, merr përsipër sigurimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.
8. SHSKUK, përmes kapaciteteve të saj profesionale e buxhetore merr përsipër mbikëqyrjen e implementimit të projektit zbatues.
9. SHSKUK, fillon ndërtimin e objektit të rezervuarit të ujit për nevoja të hemodializës me kapacitete 15000 deri 20000 litrave dhe objektin e depos nga konstruksioni i fortë në oborrin e Poliklinikës specialistike si aneks objekteve ndihmese ekzistuese.
10. SHSKUK, merr përsipër të zhvillojë procedurat e prokurimit publik në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi për punët që do të kryhen dhe pajisjet mjekësore sipas kësaj marrëveshje, deri në funksionalizimin e plotë të poliklinikës specialistike.

#### **Neni 4 Obligimet e përbashkëta**

Palët nënshkruese zotohen që krahas çështjeve të parapara me kontratë të përmbushin detyrat dhe obligimet tjera që dalin nga:

- Vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë për themelimin e Poliklinikës Specialistike në Komunën e Podujevës nr.05-2084 datë 25.03.2024.
- Vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë për miratimin e Planit të Veprimit për funksionalizimin e Poliklinikës Specialistike në Podujevë nr.05-1806 datë 13.03.2024.
- Vendimi i Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0025470/24 datë 18.04.2024 për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë SHSKUK-së.

#### **Neni 5 Kohëzgjatja**

Kontrata lidhet për periudhën nëntëdhjetë e nëntë (99) vite, duke filluar nga 11.06.2024 deri më 11.06.2123.

#### **Neni 6 Implementimi dhe mbikëqyrja e Kontratës**

1. Në mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës për zbatimin e kontratës kujdesen: Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, Drejtoria e Inspeksionit si dhe Drejtoritë dhe shërbimet tjera varësisht detyrave dhe përgjegjësi.
2. Nën mbikëqyrjen e drejtorit të SHSKUK-së, për zbatimin e Kontratës kujdesen Departamenti i Burimeve Njerëzore, Departamenti i Shërbimeve të Përgjithshme dhe Departamenti për Buxhet dhe Financa.
3. Në rast të mos realizmit apo shmangies së qëllimit të kësaj Kontrate dhe planifikimeve sipas vendimeve të lartcekura në nenin 4 që ndërlidhen me dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, Kryetari i Komunës merr vendim për shkëputjen e kontratës dhe në çdo kohë me të njëjtin e njofton Kuvendin e Komunës duke bashkëngjitur edhe rekomandimin për veprimet e më tutjeshme.

**Neni 7**  
**Mosmarrëveshjet / kontestet eventuale**

1. Në rast të ndonjë mosmarrëveshje apo kontesti eventual palët pajtohen që me vullnetin e dy anshëm zgjidhjen dhe tejkalimin ta bëjnë me mirëbesim dhe për interes publik, në të kundërtën kontesti zgjidhet në procedurë gjyqësore nga Gjykata kompetente.

**Neni 8**  
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo kontratë është hartuar në katër (4) kopje origjinale, nga dy (2) për secilën palë nënshkruese
2. Kjo kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Palët nënshkruese:*  
*Prishtinë, datë: 11.06. 2024*

**Shpejtim Bulliqi**

**Kryetar i Komunës së Podujevës**

**Elvir Azizi**

**Drejtor i ShSKUK**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenin 5 shkronja d) të Ligjit për arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenin 9 paragrafët 1 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 19 parag.1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas Rekomandimit të Komisionit vlerësues, Kryetari i Komunës, merr:

### VENDIM

#### PËR EMËRIMIN E ZËVENDËS DREJTORIT NË INSTITUCIONIN E ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL-IIAP "ISA BOLETINI" NË PODUJEVË

##### Neni 1

**z.Xhevdet Zhugolli**, me vendbanim në fshatin Siboc i Epërm, Komuna e Podujevës, me nr.personal të letërnjoftimit [REDACTED] me kualifikim Fakulteti Ekonomik dega Menaxhment dhe Informatikë.

**Emërohet në pozitën Zëvendës Drejtor në IAAP "Isa Boletini" në Podujevë.**

##### Neni 2

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e Zëvendës Drejtorit të emëruar sipas këtij vendimi, caktohen me kontratë të punës.

##### Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit.

##### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;*  
*Drejtorisë së Arsimit-DKA*  
*Të emëruarit, përmes DKA-së*  
*QSHQ/Arkivit*

**Nr.Prot. 02-101403-0037734/24**  
**Podujevë, datë: 10 qershor 2024**

**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës nr.04/L-032, nenin 5 shkronja d) të Ligjit për arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenin 9 paragrafët 1 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 19 parag.1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas Rekomandimit të Komisionit vlerësues, Kryetari i Komunës, merr:

### VENDIM

### PËR EMËRIMIN E ZËVENDËS DREJTORIT/ESHËS TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT - SHFMU "SHABAN SHALA" NË PODUJEVË

#### Neni 1

znj. **Ajshe Mehmeti**, nga fshati Brainë, Komuna e Podujevës, me vendbanim në Prishtinë, me nr.personal të letërnjoftimit [redacted] e kualifikuar Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe,

**Emërohet në pozitën Zëvendës Drejtoreshë e SHFMU "Shaban Shala" në Podujevë.**

#### Neni 2

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e Zëvendës Drejtoreshës të emëruar sipas këtij vendimi, caktohen me kontratë të punës.

#### Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;*  
*Drejtorisë së Arsimit-DKA*  
*Të emëruarës, përmes DKA-së*  
*QSHQ/Arkivit*

Nr.Prot. 02-101/03-0037728/24  
Podujevë, datë: 10 qershor 2024







Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës nr.04/L-032, nenin 5 shkronja d) të Ligjit për arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenin 9 paragrafët 1 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 19 parag.1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas Rekomandimit të Komisionit vlerësues, Kryetari i Komunës, merr:

### VENDIM

### PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT-SHFMU "SHEFKI LATIFI" NË FSHATIN POLLATË, KOMUNA E PODUJEVËS

#### Neni 1

**z.Enver Halimi**, me vendbanim në Podujevë, me nr.personal të letërnjoftimit [redacted] i kualifikuar Bachelor Teknologji-Informatikë,

**Emërohet në pozitën e Drejtorit të SHFMU "Shefki Latifi" në Fshatin Pollatë, Komuna e Podujevës**

#### Neni 2

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e Drejtorit të emëruar sipas këtij vendimi, caktohen me kontratë të punës.

#### Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;*  
Drejtorisë së Arsimit-DKA  
Të emëruarit, përmes DKA-së  
QSHQ/Arkivit

Nr.Prot.02-101/03-0037729/24  
Podujevë, datë: 10 qershor 2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 5 shkronja d) të Ligjit për arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenit 9 paragrafët 1 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 19 parag.1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas Rekomandimit të Komisionit vlerësues, Kryetari i Komunës, merr:

### VENDIM

### PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT-SHFMU "ILIR KONUSHEFCI" NË FSHATIN LLUGË, KOMUNA E PODUJEVËS

#### Neni 1

**z.Blerim Zhitia**, me vendbanim në fshatin Llugë, Komuna e Podujevës, me nr. personal të letërnjoftimit [redacted] i kualifikuar, Fakulteti Filologjik - drejtimi Letërsi dhe Gjuhë Shqipe,

**Emërohet në pozitën e Drejtorit të SHFMU "Ilir Konushefci" në fshatin Llugë, Komuna e Podujevës.**

#### Neni 2

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e Drejtorit të emëruar sipas këtij vendimi, caktohen me kontratë të punës.

#### Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;*  
*Drejtorisë së Arsimit-DKA*  
*Të emëruarit, përmes DKA-së*  
*QSHQ/Arkivit*

**Nr.Prot.** 02-101/03-0037730/24  
**Podujevë, datë: 10 qershor 2024**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenin 5 shkronja d) të Ligjit për arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenin 9 paragrafët 1 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ (MASH) nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, si dhe nenet 19 parag.1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas Rekomandimit të Komisionit vlerësues, Kryetari i Komunës, merr:

### VENDIM PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË GJIMNAZIT “ALEKSANDËR XHUVANI” NË PODUJEVË

#### Neni 1

**z.Naim Raçi**, nga Podujeva, me nr.personal të letërnjoftimit [redacted] me kualifikim Bachelor i Matematikës - Arsimor - Fakulteti i Shkencave Matematikore Natyrore,

**Emërohet në pozitën e Drejtorit të Gjimnazit “Aleksandër Xhuvani” në Podujevë.**

#### Neni 2

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e Drejtorit të emëruar sipas këtij vendimi, caktohen me kontratë të punës.

#### Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;  
Drejtorisë së Arsimit-DKA  
Të emëruarit përmes DKA-së  
QSHQ/Arkivit*

Nr.Prot. 02-101/03-0037731/24  
Podujevë, datë: 10 qershor 2024







**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF nr.04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe neneve 14 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, në Rekomandim të Komisionit vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve për financim publik të projekt propozimeve të OJQ-ve, për organizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive në Komunën e Podujevës, sipas Thirrjes publike për organizimin e aktiviteteve sportive të datës 19.03.2024, merr:

### **VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE ORGANIZATAT JO QEVERTARE-OJQ NË KOMUNËN E PODUJEVËS**

#### **Neni 1**

OJQ-të dhe Klubet Sportive për organizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive në Komunën e Podujevës sipas Thirrjes publike të datës 19.03.2024 dhe Listës përfundimtare të përfituesve të rekomanduar nga Komisioni vlerësues, mbështeten me mjete financiare në shumë të përgjithshme **81,250.00€**.

#### **Neni 2**

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, për kushtet dhe mënyrën e realizimit të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, si dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

#### **Neni 3**

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

#### **Neni 4**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

#### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.Prot. 02-400/01-0038397/24  
Podujevë, datë, 13.06.2024

Kryetari i Komunës  
Shpirtim Balliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13, 14 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 44 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, neneve 14, 16 dhe 61 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-016/01-0050861/18, jepe këtë;

## A U T O R I Z I M

Autorizohet "COST SHPED SH.P.K" me seli në Rr."Vëllezërit Gërvalla" Prishtinë BII, të cilën e përfaqësojnë z.Bujar Rama me nr.personal të letërnjoftimit [redacted] dhe z.Baton Rama me nr. peronal të letërnjoftimit [redacted] për kryerjen e shërbimeve doganore për pajisjet teknologjike të donacionit për Komunën e Podujevës (Pesë (5) Dell Optipex Micro i5 (shtëpiza) dhe 1 laptop Dell i5, për Gjinnazin "Aleksandër Gjuvani" si dhe Pesë (5) Dell Optipex Micro i5 (shtëpiza) dhe 1 laptop Dell i5, për IAAP "Fan S. Noli") të dhuruara nga z.Zejadin Dedinca me nr.personal të letërnjoftimit MPB [redacted] dhe nr.personal të Pasaportës [redacted], me vendbanim në Qytetin Montreal në Kanada.

Ky Autorizim nuk shërben dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera.

Nr.Prot. 02-016/01-0039985/24  
Podujevë, datë: 20-06-2024

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 3.3 , 11.2 dhe 26 parag 3.1 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 02-400/04-0039762/24, të datës 20.06.2024, merr:

### V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

#### Neni 1

z. [redacted] nga fshati Llapashticë e Epërme, Komuna e Podujevës, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor të bashkëshortes së tij znj.Selviqe Havolli, i jepet ndihmë financiare në shumë 1000.00€.

#### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë bankare të z.Xhevat Havolli.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS.*

*Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF*

*QSHQ/Arkivit.*

*z.Xhevat Havolli (njoftohet përmes DSHMS-së)*

Nr.prot 02-400/01-0040898/24  
Podujevë, datë, 24.06.2024







Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronjat b), c) dhe g), ndërlidhur me nenin 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 61 paragrafët 1.2) 1.3) dhe 1.7) ndërlidhur me nenin 64 paragrafët 3 dhe 4 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, jep këtë:


### A U T O R I Z I M

Autorizohet znj. Adelinë Stublla Drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Podujevë, që në emër të Komunës së Podujevës, të nënshkruaj Marrëveshje me Policinë e Kosovës - përfaqësuesin e Policisë për ofrimin e shërbimit për mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike në objektin e urgjencës në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF në Podujevë, konform draftit përkatës të Marrëveshjes, bashkëngjitur këtij autorizimi.

U dërgohet:

-Të autorizuarit  
-QSHQ/Arkivës

Nr. prot. 01-016/01-0041926/24  
Podujevë, datë: 29.06.2024



Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi